



RAPORT MONITORIMI  
SHËNDETËSIA & MBROJTJA SOCIALE  
Maj-Korrik 2020




AUTOR  
STIVEN SHALA

QENDRESA  
QYTETARE



National Endowment  
for Democracy  
*Supporting Freedom Around the World*

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)



## COVID19, në mëshirë të fatit apo në dorë të shtetit?

Përgatitja e Shqipërisë për të përballuar pandeminë e shkaktuar nga COVID-19, nisi me një Urdhër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me datë 24 Janar 2020 "Për forcimin e përgatitjes për t'u mbrojtur ndaj depërtimit së koronavirusit të ri dhe parandalimit të përhapjes së tij në Shqipëri". Në datën 24 mars 2020 qeveria shqiptare shpalli gjendjen e fatkeqësisë natyrore, kur ishin regjistruar vetëm 5 viktima nga 123 persona të prekur nga COVID-19. Sot, gjendja është shumë më shqetësuese pasi ka numër të shtuar viktimash, pozitivitet të lartë, me më shumë raste të reja në ditë se sa të shëruar. Ndëkohë menaxhimi nga ana e qeverisë vazhdon akoma të çalojë.



## Testimi i popullatës

Hapi i parë në përballjen me COVID-19 është testimi i popullatës. Për të kuptuar më shumë rreth disponueshmërisë së testeve në Shqipëri, ne ju drejtuam Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me një kërkesë për informacion. Me 17 Korrik, nëpërmjet përgjigjes, **u informuam se në Shqipëri janë në dispozicion 90 000 teste me kapacitet për kryerjen e rreth 500 – 1000 testeve në ditë.**

Po atë ditë, në vendin tonë u kryen vetëm 431 testime për të dyshuar të prekur me COVID-19. Prej asaj dite dhe ne vazhdim **numri më i lartë i testimeve (në një ditë) është 586 testime**, ndërsa dita me numrin më të ulët të testimeve ishte vetëm **267 testime**. Mesatarisht gjatë kësaj periudhe vazhdojnë të kryhen më pak se 500 testime çdo 24 orë dhe kjo është një shifër shumë e ulët, **me vetëm 1 tampon për çdo 6000 banorë**. Kjo shifër është e ulët, sidomos duke qenë se përfshin rastet e reja të dyshuara me COVID-19 si dhe tamponët që përsëriten për survejimin e rasteve positive të izoluara.

REPUBLICA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 308 prot. Tiranë, më 17.07.2020

Lënda: Kthim Përgjigje

Drejtuar: Organizatës "Qëndresa Qytetare" ✓  
Adresa: Rruga "Hoxha Tahsin", Pall. "Vjetro", Ap.23/A, Tiranë

Në përgjigje të kërkesave tuaj për informacion me nr.prot.3308, datë 10.07.2020, ju informojmë si vijon:

Aktualisht kemi në dispozicion 90 000 teste me kapacitet për kryerjen e tyre rreth 500-1000 teste në ditë, 271 respiratorë dhe afërsisht 505 shtrëtit në dispozicion për përballimin e epidemisë.


Duke ju falënderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM  
Gjezmir Proftani



Më problematike, çështja paraqitet në qytetet e vogla ku numri i tamponëve në dispozicion mbetet shumë i vogël. Me anë të një kërkesë për informacion, ne u përpoqëm të mësojmë numrin e testeve që janë realizuar çdo ditë për periudhën Maj-Korrik në qytetin e Shkodrës por në kundërshtim me nenin 3 të ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Ministria zgjodhi të mos përgjigjet. Kjo zgjedhje justifikohet fare mirë me faktin që në qytetin e Shkodrës, numri i testeve në atë periudhë rrallëherë e kaloi numrin 10. Me një popullsi prej 135 612 banorësh, ky numër kaq i ulët testimesh e bën të pamundur hetimin epidemiologjik.

Në të shumtën e rasteve, pacientët e dyshuar me COVID-19, arrijnë të testohen vetëm nëpërmjet skanerit. Po të shumta janë rastet ku qytetarët, në mungesë të testimit nga strukturat përgjegjëse, zgjedhin të vetëizolohen me shfaqjen e simptomave.



Për të kuptuar problemin me testimet i referohemi edhe një studimi të kryer nga organizata "Together for Life".<sup>1</sup> Testimet nuk kanë munguar vetëm për pacientët por edhe për personelin shëndetësor ku 40% e tyre shprehen se testimi ka munguar edhe kur ata vetë kanë shfaqur simptoma dhe 30% shprehen se kjo gjë ka ndodhur edhe pasi janë vetë-izoluar si pasojë e familjarëve që kanë shfaqur simptoma (34%). Situata paraqitet më e mirë tek spitalet e dedikuara për COVID-19 ku përqindja e testeve është gati dy herë më e lartë se në sistemin parësor.

<sup>1</sup> <https://togetherforlife.org.al/wp-content/uploads/2020/07/Sistemi-sh-C3%ABndet-C3%ABsor-gjat-C3%AB-pandemis-C3%AB-COVID-19-dhe-pajisja-e-stafit-me-materialet-e-mbrojtjes-personale.pdf>



## Mungesa e vëmendjes ndaj personelit shëndetësor

Po i njëjti studim na njeh me disa të dhëna të tjera shqetësuese. Nëse i referohemi masave mbrojtëse për personelin, spitalet si "QSUT" apo "Shefqet Ndroqi" raportojnë një situatë më pozitive, ndërkohë sistemi parësor ka pasur mungesë të dukshme të mjeteve, qoftë edhe më baziket si maskat.

Sipas stafit shëndetësor, gjatë periudhës Mars – Maj 2020 vetëm një e treta (33%) e institucioneve të sistemit shëndetësor në total, ka pasur materialet e duhura mbrojtëse për të përballuar pandeminë COVID-19. Këto mungesa kanë bërë që stafi mjekësor t'i blejë me të ardhurat e veta mjetet mbrojtëse ose t'i përdorin me kursim sasinë e mjeteve mbrojtëse në disponim e diferenca midis spitaleve covid e sistemit parësor vihet re dhe këtu ku shifrat janë respektivisht 60% me 34%. **Mungesa e masave të duhura mbrojtëse është edhe një nga shkaqet pse vetë spitalet u kthyen në vatra infeksioni për pacientët.**

Mungesa e vëmendjes ndaj personelit shëndetësor është një nga elementet më të rëndësishëm për të kuptuar menaxhimin e pandemisë në vendin tonë. Është më se e qartë se personeli shëndetësor janë popullata më e rrezikuar nga infektimi me COVID-19, ato sot po njihen si heronj, ama nevojat e tyre për t'u ndjerë të sigurt ndërkohë që ushtrojnë profesionin vazhdojnë të jenë të larta.

### Numri i mjekëve për 1000 banorë, sipas OBSH

Greqia	 4.6
Maqedonia	 2.8
Sërbia	 2.4
Mali I zi	 2.3
Bosnja	 1.8
Shqipëria	 1.2 

Duke mos plotësuar nevojat bazike për mbrojtjen e personelit, jo vetëm rrezikojmë shëndetin e tyre, por edhe atë të çdo qytetari. Sipas të dhënave nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, Shqipëria ka 1.2 mjekë për 1000 banorë - që është edhe numri më i ulët në rajon ku kryeson Greqia me 4.6 mjekë për 1000 banorë.<sup>2</sup> Për pasojë, sigurimi i jetës së personelit shëndetësor është garancia e vetme për të shmangur kolapsin total të sistemit shëndetësor në vend.

<sup>2</sup> [https://www.who.int/gho/health\\_workforce/physicians\\_density/en/](https://www.who.int/gho/health_workforce/physicians_density/en/)



Sipas raportit të OKB për rimëkëmbjen dhe reagimin socio-ekonomik ndaj COVID në Shqipëri <sup>3</sup>, **është shqetësues fakti që Shqipëria do të shpenzojë për tre vitet e ardhshme më pak se 10% për shëndetin** nga paratë e përgjithshme publike dhe se kjo tendencë është veçanërisht shqetësuese kur duhet fuqizuar sistemi shëndetësor në vend.



## Kontratat sekrete

Për të kuptuar më mirë si u menaxhua situata në Shqipëri, mjafton të shohim kontratat sekrete që qeveria ka firmosur gjatë muajve Mars-Prill 2020. Kontratat sekrete, të zbuluara nga organizata AIS e të denoncuar edhe nga opozita, ishin kryefjala e lajmeve deri në momentin që u shemb Teatri Kombëtar. Open Data Albania ka publikuar plot **15 kontrata sekrete për blerje në situatë pandemie**. <sup>4</sup>

Po çfarë janë kontratat sekrete? Sipas nenit 6 të ligjit për prokurimet publike, kontratat sekrete janë kontrata që kërkojnë masa të veçanta sigurie dhe që diktohen nga **interesa thelbësore të shtetit**. Kontrata të tilla zbatohen në rast se kemi situata që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetit. Nëse nevoja ishte kaq urgjente qeveria mund të përdorte dy nene të ligjit për prokurimet, nenin 33 për Negocimin e Drejtëpërdrejtë e atë 31 për Kërkesën sipas Proçedurës së Kufizuar, për të garantuar shërbimet në mënyrë të shpejtë dhe transparente. Cila ishte situata në rastin e pandemisë që cënon interesa thelbësore të vendit? Në rastin e një kontrate për furnizimin me produkte letre njëpërdorimshe dhe letër higjienike, është e pakuptimete pse duhet të konsiderohen "interes thelbësor i shtetit" ?



Në rastin e kontratave sekrete, qeveria, gjithmonë për arsye madhore, e eliminon garën, duke ngritur dyshime se ajo i'a ka besuar ofrimin e shërbimit klientëve afër pushtetit. Duke qenë se kontratat e këtij lloji bëhen pa garë e pa deklarim, ato janë të pamundura për t'u hetuar nga prokuroria duke mbetur subjekt i përgjegjësisë politike e jo asaj penale.

<sup>3</sup> <https://www.unicef.org/albania/sites/unicef.org.albania/files/2020-07/UN%20ALB%20Socio%20Economic%20Recovery%20%26%20Response%20Plan%201.0.pdf>

<sup>4</sup> <http://ais.al/new/blerje-per-situaten-covid-19-qeveria-shqiptare-aplikon-kontrata-sekrete-i-shmanget-pjesemarrjes-dhe-transparences/>



## Komiteti Teknik i Ekspertëve



Komiteti Teknik i Ekspertëve ishte struktura e cila u prezantua publikisht nga Ministria e Shëndetësisë dhe Kryeministri si struktura që diktonte masat dhe strategjinë nëpërmjet të cilës duhet të kalonte vendi për tu mbrojtur nga përhapja e koronavirusit.

Megjithëse kjo strukturë është kryefjala e ditës, është tepër e vështirë të gjenden informacione mbi mënyrën e funksionimit të saj, madje për një kohë të gjatë përbërja dhe drejtimi i saj mbetej i paqartë për publikun pavarësisht interesit të shtuar.


Komiteti teknik i ekspertëve vazhdon të jetë një "institucion" më vete në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim. Por ndryshe nga këto vende, ku vendimet e ndryshme në lidhje me COVID-19 merren dhe komunikohen nga ky grup ekspertësh, kjo nuk ndodhi në vendin tonë.

Nga monitorimi i komunikimit publik të Kryeministrit Edi Rama në rrjetet sociale vihet re se përgjatë izolimit, ku numri i rasteve dhe viktimave nga COVID-19 ishte i ulët, ishte Kryeministri ai që paraqitej në publik dhe komunikonte vendimet e këtij komiteti ekspertësh. Prej datës 11 Mars që shënon nisjen e karantinës deri më 18 Maj 2020, ditë nga ku nis lehtësimi i masave, Kryeministri i vendit nga 102 komunikime publike, 91 prej tyre ia ka dedikuar COVID-19 me 50.4 orë komunikim. Pas datës 18 Maj dhe në vijim nisin lehtësimet e masave duke i dhënë fund karantinës e për pasojë numrat e të infektuarve dhe viktimave nisën të rriten duke mos e renditur vendin tonë më si një 'histori suksesi' në përballimin e përhapjes së koronavirusit të ri. Prej hapjes dhe shtimit të rasteve të të infektuarve dhe numrit të vdekjeve, daljet publike të Kryeministrit Rama lidhur me pandeminë nisin të



bien ndjeshëm. Megjithëse Kryeministri Rama ka përafërsisht të njëjtën frekuencë daljesh publike me 104 komunime për periudhën 18 Maj – 30 Korrik, pjesa më e madhe e tyre i dedikohet debatit mbi sistemin elektoral, shembjes së Teatrit Kombëtar dhe procesit të rindërtimit. Vetëm 7 nga daljet publike i dedikohen COVID-19 me 2.6 orë komunikim kundrejt 91 daljeve dhe 50 orëve gjatë periudhës së karantinës.

Kurba e rasteve te reja ditore te personave te infektuar nga Covid19



Komunikim dhe daljet publike të kryeministrit të vendit



**50 ORE  
KOMUNIKIME**

92 nga 102 dalje publike  
i dedikohen Covid19

**2 ORE  
KOMUNIKIME**

7 nga 104 dalje publike  
i dedikohen Covid19

Të paktë janë edhe anëtarët e këtij komiteti që kanë guxuar të kundërshtojnë vendimet e qeverisë gjatë kësaj krize shëndetësore. Një nga të vetmet raste kur kemi një komunikim nga Komiteti është kur patëm një "betejë" midis qeverisë e opozitës mbi numrin e testimave që po kryheshin në vend. Komiteti, në kundërshtim edhe me sugjerimet e OBSH, zgjodhi të mbajë anën e qeverisë, duke thënë se numri i testimave mjaftonte. Duke analizuar gjithashtu dhe një nga vendimet më të rëndësishme të kabinetit Rama, atë të hapjes së shkollave dhe kthimit të nxënësve në keto hapësira duket se komitetit të ekspertëve nuk iu kërkua një opinion paraprak apo qëndrim por u thirr vetëm për të miratuar një udhëzues masash për të lehtësuar riskun e vendimit të marrë tashmë nga Ministria e Arsimit. Vendimi për hapjen e shkollave u mor nga opinioni i prindërve nëpërmjet një sondazhi të organizuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Nisur nga vëzhgimet e mësipërme ngrihen dyshime të arsyeshme se në Komitetin Teknik të Ekspertëve respektohet shumë pak integriteti dhe liria profesionale e ekspertëve përbërës të tij duke qenë gjatë gjithë kohës nën presionin e vendimeve të qeverisë dhe përdorimit si instrument politik.



## Përfundime

Tashmë që po bëhemi gati të hyjmë në Shtator dhe shumë ekspertë mendojnë se situata do përkeqësohet, kujdesi i shtuar i Ministrisë dhe qeverisë është i domosdoshëm.



Jo vetëm si detyrim ligjor, por edhe për të vendosur një raport besueshmërie mes qytetarëve dhe qeverisë, **transparenca në lidhje me vendimet që merren, qoftë në lidhje me shpenzimet apo me vendimet që marrin ekspertët dhe qeveria, duhet të jetë maksimale.**



Në mënyrë të menjëhershme **duhet të rritet numri i testeve**, i cili vazhdon të mbetet akoma i ulët në rang bashkie, me përjashtim të kryeqytetit.



**Testimi periodik i personelit shëndetësor dhe pajisja me mjetet e** duhura mbrojtëse duhet të jetë prioritet që të mos rrezikojmë shëndetin e personelit e as të qytetarëve që kanë nevojë të marrin shërbim të specializuar nga profesionistët.



**Pa humbur kohë, është e nevojshme ndërhyrja finaciare dhe organizative për forcimin e sistemit parësor të kujdesit shëndetësor**, pasi tashmë nuk kemi një skenar për vazhdimin e kësaj krize shëndetësore dhe COVID-19 nuk është i vetmi rrezik me të cilin po përballet sistemi ynë shëndetësor. Pacientët kanë nevojë të rikthehen në qendrat shëndetësore dhe pranë specialistëve për të ndjekur vizitat shëndetësore të prapambetura.



Komiteti Teknik i Ekspertëve duhet të gëzojë lirinë dhe pavarësinë e një institucioni të pavarur sipas modeleve të vendeve të zhvilluara, duke dalë nga presioni i vendimmarrjes së qeverisë dhe për të garantuar vendime mbi palët politike dhe në funksion të përmirësimit të situatës së shkaktuar nga COVID-19.



# #QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

Ky raport publikohet në kuadër të nismës së Qëndresës Qytetare për të nxitur transparencën dhe përgjegjshmërinë e qeverisë me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED)

Analistët e rinj të politikave publike të angazhuar në këtë nismë do të prodhojnë raporte monitoruese periodike në fushat kryesore të qeverisjes dhe do të angazhohen në përpjekje për avokim me zyrtarë të shtetit, ligjvënësit, ekspertë dhe shoqërinë civile për të promovuar rekomandime që do të rrisin transparencën dhe përgjegjshmërinë e zyrtarëve dhe qeverisë.

Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë raport i përkasin autorit realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e National Endowment for Democracy (NED) dhe Qëndresës Qytetare.



[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)

RAPORT MONITORIMI  
SHËNDETËSIA & MBROJTJA SOCIALE  
Maj-Korrik 2020